



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.536/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca- Dula, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.Z. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.K., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shukrije Tërnavë, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1/2015, i datës 21.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1/2015, i datës 21.10.2016, në pikën *I (një)* dhe *III (tre)* të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1/2015 i datës 21.10.2016, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses A.Z. nga fshati ... dhe e ka obliguar të paditurën Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga lartë përçuesi i rrjetit të energjisë elektrike me dt. 19.07.2002, t'ia paguaj dhe atë:

a)- për vendosje të protezës në gjymtyrën e sipërme të majtë në nivel të parakrahut shumë prej 20,900.00 €, me kamatë vjetore sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat për mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga 01.10.2016, e deri te pagesa definitive,

b)- në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aftësive punuese, për periodën prej 01.09.2015 e deri më 30.09.2016, shumë prej 1,735.00 €, me kamatë vjetore sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga 01.10.2016, e deri te pagesa definitive,

c)- në emër të rentës mujore shumë prej 132.68 Euro, duke filluar nga data 01.10.2016 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses në emër të fitimit të humbur në shumë prej 8,034.00 Euro për periodën e kaluar prej dt. 16.02.2009 e deri me dt. 01.09.2015.

Në pikën III (tre) e ka obliguar të paditurën t' ia paguaj paditëses shumë nga pika I nën a) dhe b) të këtij aktgjykimi si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 4,040.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa shumë nën pikën I nën c) t' ia paguaj deri me 10 të muajit për muajin paraprak, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar apo lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja A.Z. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 19.07.2002, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë (Gjykata Komunale në Lipjan) pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.235/09 të datës 08.06.2011, me të cilin e ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses dhe e ka obliguar të paditurën që për dëmin e pësuar paditëses t'ia paguaj në formë të rentës së kapitalizuar shumë prej 25,432.18 Euro si dhe në emër të shpenzimeve të vendosjes së protezës shumë prej 20,900,00 €, me kamatë vjetore 3.5%, nga data 18.08.2009 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, C.nr.235/2009 të datës 08.06.2011, ka nxjerrë aktgjykimin AC.nr.2678/2011, të datës 12.12.2014, me të cilin e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur që lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1/2015, të datës 21.10.2016, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se për shkak të mos mirëmbajtjes së rrjetit të energjisë elektrike të tensionit të lartë nga e paditura si menaxhuese e këtij rrjeti, paditësja me datën 19.07.2002 në fshatin ..., nga kontakti i saj me përçuesin e energjisë elektrike të tensionit të lartë, i cili ka qenë i lëshuar zvarrë për afërsisht një metër mbi tokë, ka pësuar lëndim të rëndë trupor me ç' rast i është amputuar krahu i majtë në regjionin e mesëm të bërrylit dhe mbi këtë bazë, bazuar në dispozitat e LMD-së e duke u bazuar edhe në aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Lipjan me të cilat paditëses dhe familjarëve të saj i është njohur kompensimi i dëmit për të gjitha format tjera të dëmit përveç fitimit të humbur dhe shpenzimeve për vendosjen e protezës, e paditura është përgjegjëse për shpërblimin e dëmit për format e kërkuara me padi. Lartësinë e kërkesëpadiës e ka mbështetur në mendimin dhe konstatimin e grupit të ekspertëve sipas të cilëve paditësja për shkak të lëndimeve të marra ka zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë prej 30% të përhershëm, për shkak të humbjes së gjymtyrës së epërme në parakrah si dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të aktuaristikës A.B. nga e cila rezulton se paditësja që nga përfundimi i studimeve në UP "Hasan Prishtina" – Fakulteti i Edukimit e deri në hartimin e ekspertizës me datë 10.10.2016 ka pësuar fitim të humbur në shumë prej 1,735.00 Euro, pra për periudhën 01.09.2015 deri më datë 30.09.2016, ndërsa nga data 01.10.2016 e derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore paditësja do të ketë fitim të munguar e cila sipas ekspertit vlerësohet në rentë mujore prej 132.68 Euro.

Mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor dhe ai financiar gjykata e shkallës së parë del tu ketë falur besimin e plotë, duke vlerësuar se përmbajnë elementet e nevojshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, duke përfshirë edhe arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare sipas çështjes kontestimore në fjalë.

Sa i përket vendimit për shpenzimet e vendosjes së protezës në shumën e aprovuar prej 20,900.00 Euro gjykata ka arsyetuar se është bazuar në profaturën e lëshuar nga ORS GmbH Orthopadie – und Rehatechnik të datës 04.04.2011 si dhe në shkresën e Shërbimit Klinik Ortopedik të QKUK-së të datës 12.07.2016 ku rekomandohet vendosja e protezës mioelektrike duke e njoftuar gjykatën se ky shërbim nuk mund të bëhet në institucionet shëndetësore në Kosovë si dhe nuk mund të vlerësohet kostoja e kësaj proteze.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, ku edhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, duke vlerësuar se është obligim ligjor i këtu të paditurës, që paditëses t'ia kompensoj shumat e gjetuara.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës për parashkrimin e kërkesës gjykata ka arsyetuar se përkundër faktit se paditësja ka pësuar lëndime në vitin 2002, ajo ka realizuar shpërblimin e dëmit për forma të tjera të tij, ndërsa duke pasur parasysh faktin se paditësja ka lindur me datë 16.02.1991 e njëjta ka arritur moshën madhore me 16.02.2009, prej kur edhe mund të parashtrohet kërkesa për fitimin e humbur për shkak se në këtë moshë e njëjta ka të drejtë pune, po ashtu edhe për vendosjen e protezës ka arsyetuar se paditësja ka marrë lëndime në moshë të re dhe përderisa e njëjta të arrin moshën madhore është e natyrshme që ajo të rritet dhe po ashtu krahu i saj të rritet dhe deri në këtë moshë edhe po ti ishte vendosur proteza ajo do të kishte pasur nevojë të ndërrohet.

Pjesën refuzuese të kërkesëpadiisë së paditëses për fitimin e humbur në shumën prej 8,034.00 €, për periudhën e kaluar nga data 16.02.2009 e deri me datë 01.09.2015, gjykata e ka arsyetuar se për këtë periudhë prej ditës kur paditësja i ka mbushur 18 vjet e njëjta ka qenë studente deri me datën 22.07.2015 dhe për këtë periudhë kohore nuk do të mund të kishte krijuar të hyra edhe po të mos kishte pësuar lëndime trupore dhe zvogëlim të aftësive punuese.

Për bazën juridike gjykata i është referuar dispozitës së nenit 154 paragrafi 2 dhe neni 174 paragrafi 1 të LMD-së (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.29), për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 277 të po të njëjtit ligj dhe neni 3 të Ligjit mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa për shpenzime të procedurës gjykata është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 dhe 5 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i përshtatshëm për përmbartim, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare qoftë për themelësinë e kërkesëpadiisë, por edhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë edhe ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Të pathemelta qëndrojnë edhe pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur me çështjen kontestuese në fjalë, qoftë sa i përket të provuarit të themelësisë së kërkesëpadiisë por edhe lartësisë së saj, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr tek ajo gjykatë, e cila gjendje faktike e vërtetuar dhe konstatuar nga gjykata e shkallës

së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit, pasi që kjo gjykatë vlerëson se ka mbështetje të plotë në provat shkresore.

Në këtë rast Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me nxjerrjen dhe analizimin e provave shkresore të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur tek gjykata e shkallës së parë e ka hetuar çështjen për vërtetimin e fakteve vendimtare në masë të mjaftueshme duke administruar në cilësi të provës materiale ekspertizën nga lëmia e aktuaristikës e punuar nga eksperti A.B. sipas së cilës ka rezultuar se renta e arritur për pagesë në periudhën nga data 01.09.2015 e deri me 30.09.2016, është në shumë prej 1,735.00 Euro, dhe në të ardhmen nga data 01.10.2016, e tutje në formë mujore nga 132.68 Euro. Këtë vlerësim të ekspertit gjykata e shkallës së parë e ka pranuar si të rregullt dhe të besueshëm, pasi që eksperti me metoda shkencore dhe profesionale ka dhënë shpjegime përkatëse për përfundimin e tij mbi lartësinë e rentës së arritur për pagesë dhe në të ardhmen. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit vlerëson se janë provuar faktet për lartësinë e kërkesës dhe atë si për rentën e arritur ashtu edhe në të ardhmen në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Edhe sa i përket kompensimit të shpenzimeve për vendosjen e protezës gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike kjo për faktin se në bazë të profaturës së lëshuar nga ORS GmbH Orthopadie – und Rehattechnik të datës 04.04.2011 e nxjerrë si provë gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë konstatohet se çmimi i protezës mioelektrike të parakrahut është 20,900.00 Euro ndërsa nga shkresa e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës- Shërbimi Klinik i Ortoprotetikës të dt. 12.07.2016 konstatohet se paditësja ka nevojë për vendosjen e protezës mioelektrike për rikthimin së paku të pjesërishëm të gjymtyrës së mbetur, mirëpo njëkohësisht me këtë është njoftuar gjykata se ky shërbim nuk mund të bëhet në institucionet shëndetësore në Kosovë si dhe nuk mund të vlerësohet kostoja e kësaj proteze, andaj rrjedhimisht edhe pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë lartësinë e kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit e ka mbështetur në profaturë kjo gjykatë e vlerëson të pabazuar ngase nevoja për vënien e protezës është vërtetuar, ndërsa në anën tjetër edhe lartësia e saj nuk ka mundur të vërtetohet në ndonjë mënyrë dhe me ndonjë provë tjetër meqë në klinikat e vendit tonë ky shërbim nuk mund të kryhet.

Gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me të drejtën materiale për përgjegjësinë e të paditurës për ta kompensuar dëmin e cila rrjedh nga dispozitat e nenit 154 dhe 174 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Sa i përket të drejtës për rentë e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të rregullt dhe gjendja faktike është në harmoni me dispozitat e nenit 185 dhe 188 të LMD-së.

Në kuptim të dispozitave të cituara e duke u mbështetur në fakte përcaktuese të provuara me mjete provuese të besueshme (*ekspertiza përkatëse*) për lartësinë e rentës së arritur dhe rentës mujore si dhe kompensimit të dëmit për vendosjen e protezës, rezulton se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e cituara ligjore.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se kërkesa e shpërblimit të dëmit sipas padisë së ushtruar është parashkruar në kuptim të nenit 376 dhe 373 të LMD, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim i pathemeltë dhe se kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të mjaftueshme ka arsyetuar këtë pretendim të t 'paditurës me të cilin qëndrim pajtohet edhe kjo gjykatë ngase kërkesa e paditëses nuk është parashkruar kjo për faktin se në momentin e shkaktimit

të aksidentit paditësja ka qenë e mitur ndërsa kërkesa për kompensimin e dëmit material në formë të rentës e cila kërkesë rrjedh si pasojë e zvogëlimit të aftësisë punuese e cila fitohet me moshën madhore 18 vjeçare e në raste të veçanta edhe me moshën 15 vjeçare, sipas dispozitës së nenit 372 par 1 të LMD-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit dhe ushtrimit të padisë në gjykatë, parashihet se kërkesat periodike në të cilën përfshihet edhe kërkesa e ushqimisë parashkruhen për 3 vjet. Kërkesa për këtë formë të dëmit është bërë e arritshme në kohën kur paditësja ka mbushur moshën madhore , pra me dt. 16.02.2009 , ndërsa padinë në gjykatë e ka ushtruar me dt. 18.08.2009, pra padia është ushtruar brenda afatit të paraparë me këtë dispozitë ligjore.

Edhe sa i përket pretendimit për parashkrimin e kërkesës për kompensimin e shpenzimeve për vënien e protezës Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë kur ka vlerësuar se kërkesa për këtë formë të dëmit nuk është parashkruar ngase bazuar në konstatimet e ekspertëve mjekësor rezulton se vënja e protezës bëhet pasi që personi ta ketë arritur moshën madhore ndërsa në rastin konkret siç u cek edhe më lartë paditësja padinë për këtë formë të dëmit e ka ushtruar brenda afatit të paraparë duke llogaritur kohën kur e njëjta ka arritur moshën madhore.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe lidhur me kamatën ligjore, pasi që kamata del të jetë gjykuar në përputhje të plotë me dispozitën ligjore të nenit 277 të LMD-së, ligj ky i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ka lindur raporti detyrimor në mes ndërgjyqësve, duke përfshirë edhe vendimin lidhur me shpenzimet procedurale të gjykuara paditësit, pasi që e paditura si palë e cila ka humbur kontestin gjyqësor në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka për detyrim që paditësit si palë gjyq fituese t'ia shpërblej shpenzimet gjyqësore, ku shpenzimet e njohura paditëses nga gjykata e shkallës së parë me shikimin në shkresat e lëndës rezulton se janë në përputhje të plotë me shpenzimet e nevojshme që ka pasur gjatë procedurës për ndjekjen e çështjes në gjyq, e që i referohen shpenzimeve lidhur me përfaqësimin e paditëses në procedurë nga i autorizuari i saj, taksave gjyqësore për padi dhe nxjerrjen e provës me ekspertiza mjekësore dhe aktuaristikës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit nuk është shqyrtuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që në këtë pjesë nuk është goditur nga pala ankuese.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.536/17, me datë 12.02.2021

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v